

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
 ZYRA E Kryeministrit - UREI QKREMTERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER  
 SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARKIVE - ARCHIVE SECTOR

Nr. Dreg. /  
 Org. Unit: 02.1.a

Nr. Dreg. /  
 Proc. No.: 1337/2

Nr. Fajde /  
 No. pages: 90

Data /  
 Date: 11 / 05 / 20 21

Prishtine/a



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRASNIJH POSLOVA  
 M: MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS  
 Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelaria e Sekretarit  
 Office of the Secretary General

Nr./Br.No.: 352 Nr./Br.str./No.pg.: 1

Data/Datum/Date: 11/05/2021

PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs**

<b>DATË/A:</b>	11 MAJ 2021
<b>REFERENC-Ë:</b>	___/2021
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Z. Arben Krasniqi , Drejtor i SKQ-së / ZKM
<b>CC:</b>	Z. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përhershëm i ZKM-së
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Lulzim Ejupi, Sekretar i Përgjithshëm i MPB-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Marrëveshja rajonale për lirinë e lëvizjes me ID cartela

I nderuar z. Krasniqi,

Në kuadër të nismave për marrëveshje ndërkombëtare që Ministria e Punëve të Brendshme ka si prioritet është edhe nisma për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për Lirinë e Lëvizjes dhe Qëndrimin të shtetasve të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Andaj bazuar në nenin 34 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, po ju dërgojmë për futjen në rend dite në mbledhjen e radhës së Qeverisë së Kosovës Propozim-vendimin për miratimin e nismës për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për Lirinë e Lëvizjes dhe Qëndrimin të shtetasve të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Bashkëngjitur gjeni:

- Projekt – marrëveshjen;

Me respekt,

## MARRVESHJA RAJONALE MBI LIRINË E LËVIZJES DHE QËNDRIMIT TË SHTETASVE TË

Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës\*, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (në tekstin në vazhdim referuar si “Palët”)

DUKE SHPREHUR vullnetin për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, me qëllim të dhënies së kontributit në zhvillimin ekonomik dhe në ngritjen e rritjes ekonomike, të investimeve dhe punësimit në Ballkanin Perëndimor,

DUKE MARRË PARASYSH rëndësinë e lëvizjes së lirë të njerëzve, me qëllim të sigurimit të përparimit dhe prosperitetit ekonomik,

DUKE MBAJTUR NË MENDJE përfundimet e Samitit të Ministrave të Brendshëm dhe të Sigurisë së gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në kuadër të Procesit të Berlinit më 16 Tetor 2020, në format të video konferencës,

DUKE MARRË NË KONSIDERATË deklaratën e liderëve nga Ballkani Perëndimor për treg të përbashkët rajonal si katalizator për integrim më të thellë ekonomik rajonal dhe një hap më afër tregut unik të BE-së, të miratuar në Samitin e liderëve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit, të mbajtur më 10 Nëntor 2020 në Sofje,

DUKE VËNË NË DUKJE se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet se përjashton Palët nga të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse sipas traktateve ekzistuese, duke përfshirë marrëveshjet e tyre ekzistuese rajonale dhe bilaterale,

Palët bien dakord si në vijim:

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Kjo Marrëveshje përshkruan kushtet reciproke të hyrjes, kalimit transit dhe qëndrimit të shkurtër të shtetasve të Palëve me letërnjoftime biometrike.

Shtetasit e Palëve për të cilët zbatohet kjo Marrëveshje kanë të drejtë të hyjnë, të kalojnë transit dhe të qëndrojnë lirshëm në territorin e Palëve për një periudhë të përcaktuar me këtë Marrëveshje.

\* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

## PËRKUFIZIMET

### Neni 2

Termat e mëposhtëm do të përdoren për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- 1) “Shtetas” - personi që ka shtetësinë e njëjës prej Palëve dhe i cili konfirmon shtetësinë e tij/saj me një letërnjoftim të vlefshëm biometrik;
- 2) “Legjislacioni i brendshëm” - ligjet dhe rregulloret e tjera që janë në fuqi në njërin nga vendet e Palëve;
- 3) “Dokument personal biometrik” - letërnjoftim i vlefshëm biometrik (ID);
- 4) “Pala Pritëse” - territori i Palës në të cilën hyjnë shtetasit e Palës tjetër (përmes trafikut tokësor, detar dhe ajror), kalojnë transit dhe qëndrojnë për një periudhë të shkurtër siç përcaktohet në këtë Marrëveshje;
- 5) “Qëndrim i shkurtër” - jo më shumë se 90 ditë gjatë çdo periudhë 180 ditore.

## HYRJA, LËVIZJA, KALIMI TRANSIT DHE QËNDRIMI

### Neni 3

Palët thjeshtojnë procedurat administrative për hyrje, kalim transit dhe qëndrim të shkurtër të shtetasve të Palëve me letërnjoftime.

Palët garantojnë që shtetasit e Palëve të tjera do të kenë të drejta të barabarta për të hyrë, qëndruar dhe kaluar transit në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin e brendshëm.

### Neni 4

Shtetasi i njëjës prej Palëve mund të hyjë në territorin e Palës tjetër, në përputhje me këtë Marrëveshje, me kusht që:

- 1) ai/ajo ka posedon letërnjoftim të vlefshëm biometrik, me vlefshmëri prej së paku 3 muaj;

- 2) ai/ajo nuk ka ndonjë ndalesë të hyrjes dhe qëndrimit në territorin e Palës tjetër;
- 3) ai/ajo nuk përbën kërcënim për sigurinë ose shëndetin publik të Palës tjetër, të vërtetuar me informacione dhe të dhëna objektive, konkrete dhe përkatëse, si dhe me të dhëna nga autoritetet kompetente.

Dispozitat bilaterale të dakorduara tashmë midis Palëve, për t'iu mundësuar shtetasve të tyre që të hyjnë me lloje të tjera të dokumenteve, do të merren parasysh dhe do të trajtohen në përputhje me rrethanat.

Kur hyni dhe kaloni transit në territorin e njëri-tjetrit, leximi i detyrueshëm elektronik i dokumentit personal të vlefshëm biometrik dhe regjistrimi i të dhënave gjatë kontrollit të realizuar kufitar kryhet për shtetasit e Palëve të tjera.

#### Neni 5

Secila Palë, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, rezervon të drejtën për t'i revokuar lejen e qëndrimit të një shtetasi të Palës tjetër në territorin e saj.

#### Neni 6

Palët shkëmbejnë ekzemplarët e letërnjoftimeve biometrike jo më vonë se 30 ditë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Në rast të modifikimit, revokimit ose aplikimit të llojeve të reja të letërnjoftimeve biometrike, Palët paraqesin ekzemplarët jo më vonë se tri javë pas modifikimit të aplikuar dhe ofrojnë informacione lidhur me kushtet e përdorimit të tyre.

Palët pajtohen që të vejnë në dispozicion në mënyrë elektronike të dhënat e dokumenteve personale biometrike që janë deklaruar si të pavlefshme.

#### Neni 7

Çdo çështje që nuk është e rregulluar me këtë Marrëveshje do të rregullohet sipas legjislacionit të brendshëm të Palës Pritëse dhe marrëveshjeve të zbatueshme ndërkombëtare.

## Neni 8

Shtetasit e një Pale i binden legjislacionit të brendshëm të Palës Pritëse gjatë hyrjes, kalimit transit dhe gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër.

## Neni 9

Dispozitat e kësaj Marrëveshje nuk zbatohen për sa i përket përmbushjes së kërkesave për të aplikuar për qëndrim të përhershëm në vendin e Palës Pritëse.

Një shtetas i Palës që synon të aplikojë për qëndrim të përhershëm në vendin e Palës Pritëse është i detyruar të veprojë në përputhje me legjislacionin e Palës Pritëse.

## KOMISIONI

### Neni 10

Duke u bazuar në këtë Marrëveshje, do të krijohet një Komision i cili do të ngarkohet me organizimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 11

Komisioni përbëhet prej dy përfaqësuesve të secilës Palë.

Puna e Komisionit do të koordinohet nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC).

### Neni 12

Komisioni takohet së paku një herë në vit dhe i raporton Palëve çdo gjashtë muaj lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 13

Kjo Marrëveshje, mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e të gjitha Palëve që i nënshtrohen të njëjtës procedurë, e cila ishte e nevojshme për të lidhur këtë Marrëveshje.

### Neni 14

Palët pajtohen se do të diskutojnë në nivel Komisioni çdo mosmarrëveshje që ngritët nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 15

Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit nga Palët, në përputhje me procedurat e tyre. Njoftimi i miratimit depozitohet tek Depozitari i Marrëveshjes \_\_\_\_\_, i cili është i detyruar të njoftojë Palët për këtë, dhe që do të kryejë të gjitha funksionet e tjera të Depozitarit.

### Neni 16

Kjo Marrëveshje duhet të hyjë në fuqi deri më 1 Janar 2022.

### Neni 17

Nëse njëra Palë tërhiqet nga kjo Marrëveshje, atëherë Marrëveshja pushon së qeni e efektshme vetëm për atë Palë brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të këtij njoftimi.

Neni 18

Marrëveshja është lidhur në gjuhën angleze, ku secila Palë nënshkruese do ta mbajë një kopje të saj.

Përpiluar në \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ 2021

Simjali

## **REGIONAL AGREEMENT ON THE FREEDOM OF MOVEMENT AND STAY OF CITIZENS OF**

Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo\*, Montenegro, North Macedonia and Serbia (hereinafter referred to as “Parties”)

EXPRESSING willingness for strengthening regional cooperation and mutual understanding, with the aim of contributing to economic development and increase of economic growth, investments and employment in the Western Balkans,

CONSIDERING the importance of free movement of people, with the aim of ensuring progress and economic prosperity,

BEARING IN MIND the Conclusions of the Summit of Ministers of Interior and Security of Western Balkans six economies held in video format under the framework of the Berlin Process on 16 October 2020,

TAKING INTO CONSIDERATION the Western Balkans Leaders Declaration on Common Regional Market - A catalyst for deeper regional economic integration and a stepping stone towards EU Single Market adopted at the Summit of the Western Balkans leaders under the framework of the Berlin Process, held in Sofia on 10 November 2020,

NOTING that no provision of this Agreement may be interpreted as to exempt the Parties from their respective rights and obligations under existing treaties, including their existing regional and bilateral agreements,

The Parties hereby agree as follows:

### **GENERAL PROVISIONS**

#### **Article 1**

This Agreement prescribes the conditions of mutual entry, transit and short stay of citizens of the Parties with biometric ID cards.

Citizens of the Parties to which this Agreement applies shall have the right to enter, transit and stay freely on the territory of the Parties for the period specified by this Agreement.

\*This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of independence.



## DEFINITIONS

### Article 2

The following terms shall be used for the purposes of this Agreement:

- 1) "Citizen" – a person who holds the citizenship of one of the Parties, and who confirms his/her citizenship with a valid biometric ID card;
- 2) "Domestic legislation" – laws and other regulations which are in force in one of the Parties;
- 3) "Biometric personal document"– valid biometric identity card (ID);
- 4) "Receiving Party"– the territory of the Party into which the citizens of the other Party enter (land, sea and air traffic), transit and stay for a short period as stipulated by this Agreement;
- 5) "Short stay" - not more than 90 days in any 180-day period.

## ENTRY, MOVEMENT, TRANSIT AND STAY

### Article 3

The Parties shall simplify the administrative procedures for entry, transit and short stay of the Parties' citizens with ID cards.

The Parties shall guarantee that citizens of other Parties shall have equal rights to enter, stay and transit in accordance with this Agreement and domestic legislation.

### Article 4

A citizen of one of the Parties may, in accordance with this Agreement, enter the territory of the other Party provided that:

- 1) he/she has a valid biometric ID card, with at least 3 months validity;
- 2) he/she has no ban on entry and stay in the territory of the other Party;

- 3) he/she does not pose a threat to the security or public health of the other Party, substantiated by objective, concrete and relevant information and data provided by the competent authorities.

Already agreed bilateral provisions between the Parties on enabling their citizens to enter with other types of documents will be taken into account and treated accordingly.

When entering and transiting one another's territory mandatory electronic reading of a valid biometric personal document and recording of data on the performed border check shall be carried out for the citizens of the other Parties.

#### Article 5

Each Party, in accordance with its domestic legislation, shall reserve the right to revoke the stay on its territory to a citizen of the other Party.

#### Article 6

The Parties shall exchange specimens of biometric ID cards not later than 30 days before this Agreement enters into force.

In the event of modification, revocation or introduction of new types of biometric ID cards, the Parties shall submit specimens not later than three weeks after the introduced modification and provide information about the conditions of their use.

The Parties agree to electronically make available the data on biometric personal documents that have been declared invalid.

#### Article 7

Any matter that is not regulated by this Agreement shall be governed by the domestic legislation of the Receiving Party and applicable international agreements.

## Article 8

Citizens of one Party shall abide by the domestic legislation of the Receiving Party at the time of entry, transit and stay on the territory of the other Party.

## Article 9

The provisions of this Agreement shall not apply with respect to the fulfilment of the requirements for applying for permanent stay in the Receiving Party.

A citizen of the Party who intends to apply for permanent stay in the Receiving Party shall be obliged to act in accordance with the legislation of the Receiving Party.

## COMMISSION

### Article 10

A Commission shall be established based on this Agreement tasked with organising, coordinating and monitoring activities related to the implementation of this Agreement.

### Article 11

The Commission shall be composed of two representatives of each Party.

The work of the Commission shall be coordinated by the Regional Cooperation Council (RCC).

### Article 12

The Commission shall meet at least once a year and shall report every six months to the Parties about the implementation of this Agreement.

## TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS

### Article 13

This Agreement may be amended only with the consent of all Parties subject to the same procedure which was necessary to conclude this Agreement.

### Article 14

The Parties agree that any disputes arising from the implementation of this Agreement shall be discussed at the level of the Commission.

### Article 15

This Agreement shall be subject to ratification by the Parties in accordance with their own procedures. Notification of approval shall be deposited with the Depository of the Agreement \_\_\_\_\_, which shall be obliged to notify the Parties thereof and which shall perform all other functions of the Depository.

### Article 16

This Agreement shall enter into force by 1 January 2022.

### Article 17

If one Party withdraws from this Agreement, it shall cease to be effective only for that Party within 30 days from the date of delivery of the notification thereof.

Article 18

The Agreement is concluded in English language, of which each Signatory shall retain one copy.

Done at \_\_\_\_\_ on \_\_\_\_\_ 2021

Simjali

## REGIONALNI SPORAZUM O SLOBODI KRETANJA I BORAVKU GRAĐANA

Albanija, Bosna i Hercegovina, Kosovo\*, Crna Gora, Severna Makedonija i Srbija (u daljem tekstu „Strane ”)

IZRAŽAVAJUĆI volju za jačanjem regionalne saradnje i međusobnog razumevanja, sa ciljem doprinosa ekonomskom razvoju i povećanju ekonomskog rasta, investicija i zapošljavanja na Zapadnom Balkanu,

RAZMATRAJUĆI važnost slobodnog kretanja ljudi, sa ciljem osiguranja napretka i ekonomskog prosperiteta,

IMAJUĆI U VIDU zaključke samita ministara unutrašnjih poslova i sigurnosti šest ekonomija Zapadnog Balkana održanog u video formatu u okviru Berlinskog procesa 16. oktobra 2020.,

UZIMAJUĆI U OBZIR Deklaraciju lidera Zapadnog Balkana o zajedničkom regionalnom tržištu - katalizator za dublju regionalnu ekonomsku integraciju i odskočnu dasku ka jedinstvenom tržištu EU usvojenu na Samitu lidera Zapadnog Balkana u okviru Berlinskog procesa, održanom u Sofiji 10. novembra 2020,

NAPOMINJUĆI da se nijedna odredba ovog sporazuma ne može tumačiti kao izuzeće strana od njihovih odgovarajućih prava i obaveza prema postojećim ugovorima, uključujući njihove postojeće regionalne i bilateralne sporazume,

Strane su se složile kako sledi:

### OPŠTE ODREDBE

#### Član 1

Ovim sporazumom propisani su uslovi uzajamnog ulaska, tranzita i kratkog boravka građana strana sa biometrijskim ličnim kartama.

Građani strana na koje se odnosi ovaj sporazum imaće pravo ulaska, tranzita i slobodnog boravka na teritoriji strana tokom perioda određenog ovim sporazumom.

\* Ova oznaka ne dovodi u pitanje stavove o statusu i u skladu je sa Rezolucijom UNSCR 1244/1999 i mišljenjem MSP-a o proglašenju nezavisnosti Kosova.

## DEFINICIJE

### Član 2

Sledeći pojmovi će se koristiti u svrhe ovog sporazuma:

- 1) „Građanin“ - osoba koja ima državljanstvo jedne od strana i koja svoje državljanstvo potvrđuje važećom biometrijskom ličnom kartom;
- 2) „Domaće zakonodavstvo“ - zakoni i drugi propisi koji su na snazi u jednoj od strana;
- 3) „Biometrijski lični dokument“ - važeća biometrijska lična karta (ID);
- 4) „Strana prijema“ - teritorija Strane na koju ulaze državljani druge Strane (kopneni, morski i vazdušni saobraćaj), vrše tranzit i borave na kraći period kako je predviđeno ovim Sporazumom;
- 5) „Kratak boravak“ - ne više od 90 dana u bilo kojem periodu od 180 dana.

## ULAZAK, KRETANJE, TRANZIT I BORAVAK

### Član 3

Strane će pojednostaviti administrativne postupke za ulazak, tranzit i kratki boravak državljana Strana sa ličnim kartama.

Strane će garantovati da će državljani drugih strana imati jednaka prava na ulazak, boravak i tranzit u skladu sa ovim Sporazumom i domaćim zakonodavstvom.

### Član 4

Građanin jedne od Strana može, u skladu sa ovim Sporazumom, ući na teritoriju druge Strane pod uslovom da:

- 1) ima važeću biometrijsku ličnu kartu sa rokom važenja najmanje 3 meseca;
- 2) nema zabranu ulaska i boravka na teritoriji druge strane;

- 3) ne predstavlja pretnju sigurnosti ili javnom zdravlju druge strane, potkrepljeno objektivnim, konkretnim i relevantnim informacijama i podacima koje su dostavili nadležni organi.

Već dogovorene bilateralne odredbe između strana o omogućavanju njihovim građanima da uđu sa drugim vrstama dokumenata biće uzete u obzir i u skladu sa tim će se postupati.

Pri ulasku i tranzitu preko teritorija vrši se obavezno elektronsko očitavanje važećeg biometrijskog ličnog dokumenta i evidentiranje podataka o izvršenoj graničnoj kontroli za građane ostalih strana.

#### Član 5

Svaka strana, u skladu sa svojim domaćim zakonodavstvom, zadržava pravo da opozove boravak na svojoj teritoriji državljaninu druge strane.

#### Član 6

Strane će razmeniti uzorke biometrijskih ličnih karata najkasnije 30 dana pre stupanja na snagu ovog sporazuma.

U slučaju izmene, opoziva ili uvođenja novih vrsta biometrijskih ličnih karata, strane će dostaviti uzorke najkasnije tri nedelje nakon uvedene izmene i pružiti informacije o uslovima njihove upotrebe.

Strane se slažu da će elektronski učiniti dostupnim podatke o biometrijskim ličnim dokumentima koji su proglašeni nevažećim.

#### Član 7

Bilo koja stvar koja nije regulisana ovim Sporazumom uređivaće se domaćim zakonodavstvom Strane prijema i primenjivim međunarodnim ugovorima.



## PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE

### Član 13

Ovaj sporazum se može izmeniti i dopuniti samo uz saglasnost svih strana podložnih istom postupku koji je bio potreban za zaključenje ovog sporazuma.

### Član 14

Strane se slažu da će se o svim sporovima koji proiziđu iz primene ovog sporazuma raspravljati na nivou Komisije.

### Član 15

Strane će ratifikovati ovaj sporazum u skladu sa svojim procedurama. Obaveštenje o odobrenju deponovaće se kod depozitara Sporazuma \_\_\_\_\_, koji će biti dužan obavestiti strane o tome i koji će obavljati sve ostale funkcije depozitara.

### Član 16

Ovaj sporazum stupa na snagu 1. januara 2022.

### Član 17

Ako se jedna strana povuče iz ovog sporazuma, on prestaje da važi samo za tu stranu u roku od 30 dana od dana dostave obaveštenja o tome.

### Član 18

Ugovor je zaključen na engleskom jeziku, od kojih će svaka potpisnica zadržati po jedan primerek.

Sastavljeno u \_\_\_\_\_ dana \_\_\_\_\_ 2021

Smjani